



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja
Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development

ZYRA PER KOMUNIKIM ME PUBLIKUN/ KANCELARIJA ZA JAVNO KOMUNICIRANJE
OFFICE OF PUBLIC COMMUNICATION

THIRRJE PËR APLIKIM PËR FERMERËT DHE EKONOMITË BUJQËSORE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

PËR PËRFITIM NË KUADËR TË IMPLEMENTIMIT TË “PLANIT PËR BUJQËSI
DHE ZHVILLIM RURAL 2007-13”, MBËSHTETJE PËR INVESTIME MASA 3:
“UJITJA E TOKAVE BUJQËSORE”

Qëllimi i thirrjes për aplikim

Qëllimi i thirrjes për aplikim është dhënia e mbështetjes financiare/granteve për investime në ferma në kuadër të **Masës 3: “Ujitja e tokave bujqësore”**

1. Kriteret e pranueshmërisë

Përfituesit e mundshëm janë fermerët si persona fizik apo persona juridik, grupet e fermerëve, shoqatat e fermerëve, shoqatat e ujitjes, etj.

Statusi ligjor i pronës në të cilën do të ndërtohet sistemi i ujitjes duhet të jetë i qartë. Duhet të ekzistoj zotimi në parim për të kontribuar me 20% për realizimin e projektit. Sipërfaqja minimale nën ujitje e projektit: 2 ha

Të gjithë përfituesit e projekteve duhet të respektojnë rregullat dhe procedurat e prokurimit publik që janë të bashkangjitura si shtojcë e kontratës që fermeri e nënshkruan me Agjencionin e Zhvillimit të Bujqësisë

2. Shtrirja gjeografike

Tërë territori i Republikës së Kosovës

3. Investimet e pranueshme

- rehabilitimi dhe modernizimi i infrastrukturës ekzistuese të ujitjes;
- hapjen e puseve;
- ndërtimin e rezervuarëve të ujit për ujitje;
- kyqje në kanale të furnizimit publik;
- blerjen e pompave dhe pajisjeve percjellëse;
- shtrirja e rrjetit të gypave për sistemin e shpërndarjes së ujit;
- hapja dhe ndërtimi i kanaleve sekondare për ujitje;
- pajisjeve për matjen e ujit, pajisjet për kontrollin e rrjedhës;
- punët percjellëse me ndikim në mjedis, drenazhim (tarracat, nivelimi i tokës, varësisht nga lloji i projektit).

Aktivitetet e mëposhtme përgatitore dhe mbikëqyrëse janë të pranueshme për përkrahje:

- Skicat/ dizajnimet e hollësishme të projektit inxhinierik;
- Vlerësimi i ndikimit mjedisor;
- Përgatitja e dokumenteve të aplikimit.

Një aplikant nuk mund të aplikojë vetëm për financim të aktiviteteve të lartpërmendura. Aplikimi duhet të jetë për tërë projektin dhe përfshin aktivitetet përgatitore dhe shpenzimet e investimit lidhur me ndërtimin dhe mbikëqyrjen e projektit.

4. Dokumentet e nevojshme

- Formulari i aplikimit me projekt propozimin, sipas formës standarde të MBPZHR-së;
- Plani i biznesit si pjesë e formularit për aplikim për projektet në vlerë mbi 20.000 euro;
- Kopje e një llogarie bankare të vlefshme;
- Kopja e certifikatës së biznesit nëse është biznes;
- Kopja e letërnjoftimit të menaxherit dhe të personit të autorizuar (përfaqësues të biznesit);

a) Pas përzgjedhjes së projektit, kërkohet:

- Kopja mbi vlerësimin e ndikimit mjedisor nga MMPH

5. Niveli i mbështetjes dhe intensiteti i ndihmës publike

Kosto minimale e investimit të pranueshëm: 5000 euro

Kosto maksimale e investimit të pranueshëm: 100.000 euro

Intensiteti i mbështetjes publike është 80% e shpenzimeve të pranueshme

6. Shpenzimet e papranueshme janë:

- artikujt tashmë të financuar në kuadër të ndonjë kornize tjetër;
- blerja e tokës apo ndërtesave;
- zëvendësimet/renovimet e thjeshta të ndërtesave apo makinerisë;
- tatimet, përfshirë TVSH-në, përveç nëse përfituesi (apo partnerët e përfituesit) nuk mund t'i kthejnë ato dhe rregulloret e aplikueshme nuk ndalojnë mbulimin e tatimit;
- blerjet e pajisjeve të përdorura;
- gjobat, ndëshkimet financiare dhe shpenzimet gjyqësore;
- kontributet në natyrë;
- shpenzimet e amortizimit (zhvlerësimi);
- shpenzimet operative;
- shpenzimet për doganim apo import, apo pagesa tjera.

Mjetet financiare për këtë Masë janë: 1,000.000 euro

Koha dhe mënyra e pranimit të aplikacioneve

Thirrja për aplikim do të jetë e hapur 60 ditë nga data e publikimit. Investimi duhet të bëhet në afat prej 120 ditësh nga data e aprovimit të projektit.

Të gjitha pagesat mbi shumën 500 euro duhet të bëhen përmes transferit bankar. Për pagesat më të vogla se 500 euro, duhet të merret fatura dhe kuponi fiskal.

Data e fillimit të dorëzimit të formularit për aplikim është dita pasi të jetë publikuar thirrja për aplikim.

Përfituesi duhet të shkojë në Zyrën Komunale ose drejtpërdrejt në Zyrën Komunale Këshilluese dhe të marrë dokumentet e nevojshme për të aplikuar.

Me përkrahjen e zyrtarit këshillues komunal ose vetë përfituesi bën plotësimin e formularit për aplikim dhe siguron dokumentet e nevojshme.

Formulari për aplikim dhe dokumentet e bashkangjitura duhet të dorëzohen në zyrën komunale për bujqësi, çdo ditë pune nga ora 09:00-15:30.

X. Kontaktet dhe pikat (vendet) informuese lidhur me aplikimin

MBPZHR /AZHB				
Nga e hëna deri të premten nga ora 10:00-12:00			e-maili	
1	Nehat Veliu		038 211 967	Nehat.veliu @rks-gov.net
Drejtoria Komunal të Bujqësisë				
Nga e hëna deri të premten nga ora 09:00-15:30				
Nr.	Komuna	Personi kontaktues	Telefoni	e-maili
1	Drenas	Halit Bytyqi	044/ 170-772	bujqesia_dr@hotmail.com
2	F.Kosovë	Sylejman Shabani	044/ 277-984	sulejmanshabani@hotmail.com
3	Prishtinë	Ylli Demolli	044/277-610	yll_demolli@hotmail.co.uk
4	Lypjan	Njazi Ibrahimimi	044/ 111-949	nijazi_ibrahimi@hotmail.com
5	Podujeva	Xhafer Sekiraqa	044/ 185-127	xhafa-345@hotmail.com
6	Shtime	Ejup Ismajli	044/ 201-876	ejup_ismajli@hotmail.com
7	Obiliq	Musli Mjeku	044/ 316-801	mmjeku@hotmail.com
8	Graçanica	Goran Gjorgjeviq	049/ 776-582	Nicic_86@hotmail.com
9	Dragash	Flamur Sylejmani	044/ 622-121	flamursylejmani2@hotmail.com
10	Rahovec	Nystret Shala	044/925-858	n.shala5@hotmail.com
11	Mamushë	Jyksen Topoan	044/ 131-781	ytopovan@hotmail.com
12	Prizreni	Jakup Kastrati	044/ 113-121	jakup.k@hotmail.com
13	Malishevë	Milaim Morina	044/ 302-523	milaim08@gmail.com
14	Suharekë	Shaqir Kryeziu	049/ 449-381	shaqa63@hotmail.com
15	Gjilan	Medin Zeqiri	044/ 212-484	medinzeqiri@yahoo.com
16	Viti	Veton Ademi	044/30-7428	V_dika@hotmail.com
17	Novo Bërd	Avdi Vllasaliu	044/ 293-331	avdi.vllasaliu@hotmail.com
18	Kamenicë	Bektesh Dermaku	044/ 428-511	bekteshdermaku@hotmail.com
19	Klllokot	Dosta Mesiq	044/ 722-274	dalja-75@hotmail.com
20	Partesh	Verica Milosheviq	044/ 330-616	milosevic_verica@yahoo.com
21	Ranilluk	Vlladimir Stojaniviq	044/ 434-595	vlladastojanovic83@yahoo.com

22	Ferizaj	Bashkim Mani	044/130-493	b-mani@hotmail.com
23	Kaçanik	Zekirja Koxha	044/ 130-047	koxha_zeki@hotmail.com
24	Shtërpcë	Fazli Islami	044/ 32- 784	fazliislami@hotmail.com
25	Hani I Elezit	Selvet Shreta	044/479-883	besnik.reci@hotmail.com
26	Mitrovicë	Bedri Bajrami	044/ 245-821	bedribajrami_055@yahoo.com
27	Vushtrri	Avdyl Feka	044/ 295-627	avdyl.feka@hotmail.com
28	Skenderaj	Sabit Ferizi	044/ 215-098	sabitferizi@hotmail.com
29	Leposaviq			
30	Zubin Potok			
31	Zveqan			
32	Junik	Ali Gacaferri	044/ 997-169	aligacaferri@hotmail.com
33	Istog	Mujë Osmanaj	044/ 429-698	mujosmanaj@hotmail.com
34	Deçan	Bajram Çekaj	044/ 154-890	bareci_17@hotmail.com
35	Pejë	Mehdi Mula	044/ 165-225	mmulaj@hotmail.com
36	Klinë	Rexhep Rexhepi	044/ 223-165	rexha_61@hotmail.com
37	Gjakovë	Agron Zorra	044/ 350-417	agronz1@hotmail.com